

KONFERENCË PËR SHTYP/ MINISTRJA PIRDENI PREZANTON PAKETËN E NISMAVE LIGJORE ANTIKORRUPSION

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, prezantoi paketën e 5 nismave ligjore antikorrupsion, të cilat synojnë forcimin e integritetit, rritjen e transparencës dhe parandalimin e korrupsionit, në përputhje me standardet evropiane. Paketa përfshin ligjin për sinjalizuesit, lobimin, sponsorizimet dhe donacionet, parandalimin e konfliktit të interesit dhe financimin e partive politike, të gjitha të konsultuara gjerësisht ose në proces konsultimi me Komisionin Evropian dhe shoqërinë civile. Të gjitha këto nisma vijnë në një mjedis që e gjen Shqipërinë më të përgatitur se më parë për të parandaluar korrupsionin.



TAKIM SHQIPËRI-GJERMANI PËR REFORMIMIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, znj. Adea Pirdeni, zhvilloi sot një takim me Ministrin e Shtetit për Evropën në Ministrinë e Jashtme Federale të Gjermanisë, Günther Krichbaum. Një bisedë e frytshme, e cila u përqendrua në përpjekjet në kuadër të reformimit të administratës publike dhe luftës kundër korrupsionit, si pjesë e pandarë e procesit të negociatave për aderimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Mbështetja e gjithëhershme e Gjermanisë mbetet thelbësore për konsolidimin e besimit në nivelin e Bashkimit Evropian se progresi i Shqipërisë është i qëndrueshëm dhe se agjenda jonë evropiane po ecën me hapa të sigurt.



PËR HERË TË PARË, LOBIMI RREGULLOHET ME LIGJ

Me 83 vota, Kuvendi miratoi projektligjin "Për lobimin në Republikën e Shqipërisë", me nismë të Këshillit të Ministrave dhe propozim të Ministres së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Adea Pirdeni. Ligji rregullon për herë të parë veprimtarinë e lobimit si një aktivitet të ligjshëm, transparent dhe të gjurmueshëm, duke synuar rritjen e përgjegjshmërisë në ndërveprimet mes grupeve të interesit dhe institucioneve publike. Projektligji u konsultua gjerësisht me shoqërinë civile dhe ekspertë ndërkombëtarë, u shqyrtua në katër komisione parlamentare dhe parashikon regjistrimin e detyrueshëm të lobistëve dhe deklarimin e kontakteve me zyrtarët publikë.



MINISTRJA PIRDENI MORI PJESË NË DIALOGUN POLITIK NË ROMË

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Adea Pirdeni mori pjesë në Dialogun Politik në Romë, mbi procesin e anëtarësimit të Shqipërisë dhe Malit të Zi në Bashkimin Evropian.

Dialogu shërbeu si një platformë për diskutime të thelluara mbi sfdat e procesit të negociatave, me fokus të veçantë në fushat e shtetit të së drejtës. Ministria Pirdeni theksoi angazhimin e pandërprerë të Shqipërisë për të ruajtur ritmin e procesit të negociatave dhe për t'i qëndruar besnikë zotimit për mbylljen e negociatave në nivel teknik brenda vitit 2027.

